

UDHA ISLAMIE

Viti XII - Nr. 5 (135), Maj, 2014

E përnuajshme Informativ - Fetare - Kulturore - Edukative

Botim i Myftinisë Shkodër

29 MAJ 1453 - ÇLIRIMI I KOSTANDINOPOJËS



**“Biri im, përhapja e Islamit në tokë është detyrë e mbretërve,
puno për përhapjen e fesë së All-llahut sa të mundesh!
Biri im, le të jetë fjala e fesë mbi çdo fjalë tjetër!
Mos lër pas dore asnjë urdhër nga urdhrat e fesë...
Biri im, mbaji afër vetes dijetarët dhe madhëroje pozitën e tyre...”**

(porosia që Sulltan Mehmet Fatihu i la të birit, Bajazidit II)



Hfz. Mehas Alija

Imam në xhaminë "El-Hidaje", Zvicër

Falënderimet dhe lëvdatat më të mëdha janë për Allahun e Madhëruar, Zotin dhe Krijuesin e të gjitha botëve. Selami dhe përshëndetjet tona qofshin edhe për të Dërguarin e Allahut, Muhammedin Alejhisselam, mbi familjen e tij të madhe, mbi shokët e tij dhe mbi të gjithë ata që jetuan me të vërtetën në zemër.

* * *

"Le të frikësohen ata (në prag të vdekjes) sikur të linin pas vete pasardhës të paaftë për të cilët kanë dro (si do të jetë gjendja e tyre) le t'i ruhen All-llahut (dënimit të Tij) dhe le t'ju thonë (jetimëve) fjalë prindore." (Nisa, 9)

Allahu xh.sh., kërkon nga besimtari që, në radhë të parë, të shpëtojë vetveten dhe familjen e tij nga zjarri i xhehennemit. Njeriu ka shumë përgjegjësi, mirëpo përgjegjësia ndaj familjes, respektivisht ndaj fëmijëve është shumë më e madhe dhe më me prioritet. Njeriu, ose prindi, duhet të tregojë kujdes të veçantë ndaj fëmijëve, mbi ecurinë e zhvillimit të arsimit dhe edukimit të tyre. Edukimi, përgjithësisht, është një detyrë e komplikuar. Një pedagog i shquar ka konstatuar: *"Deri sa nuk kisha fëmijë, kisha gjashtë teori mbi edukimin, kurse tani kam gjashtë fëmijë, dhe asnjë teori."*

Nuk ka ndonjë metodë specifike, e cila do të ishte e zbatueshme për secilin fëmijë, pasi që, çdo njëri, është botë në vete dhe kërkon qasje autentike specifike.

KAPE EVLADIN TËND PËR DORE DHE FUTE NË XHENNET

Për edukimin e pasardhësve duhet të ekzistojë dëshira dhe vullneti ynë i fuqishëm dhe kjo duhet të dëshmohet edhe në jetën tonë praktike. Nëse e duam edukatën fetare te gjeneratat e reja, gjegjësisht tek fëmijët tanë, atëherë duhet që t'i shfrytëzojmë institucionet fetare që ndihmojnë në këtë proces, porse, njëkohësisht, duhet mbështetur edhe në Allahun xh.sh., kurse Ai, definitiv ju ndihmon robërve të tij të sinqertë.

Nga ana tjetër, në Ahiret do të pyetemi për fëmijët tanë, ashtu siç tani me të drejtë pyesim se ku i kemi ata? Në ç'drejtim janë duke ecur? Të shumta janë vendet që tërheqin vëmendjen e fëmijëve tanë, ndërkohë që i shohim duke na i devijuar ata. Vendet e kumarllëkut, kafe-bareve, vendet ku pihet alkooli dhe droga, janë rrugët që shkatërrojnë të ardhmen tonë.

Një prind i përgjegjshëm e di se ku e ka fëmijën e vet. E di se ku del dhe e lajmëron për çdo gjë që mund t'ia rrezikojë jetën. Muhammedi a.s., e lajmëron besimtarin që të mos ec rrugës së dyshimtë dhe të mos shkojë në vendet në të cilat ofrohet pa kontroll alkooli. Prindi i përgjegjshëm, një prind musliman, ndërton raporte të hapura komunikimi dhe besimi me fëmijët e vet, ashtu që nuk lejon që midis tyre të ketë fshehtësi dhe sjellje për të cilat nuk do të ishte i informuar. Do të ishte nënçmim për një prind nëse të tjerët do t'i tregonin për veset dhe punët e fëmijës së tij, ndërkohë ai të mos di asgjë në lidhje me to.

Ne si prindër nuk mund të ndikojmë që të mos hapen kafe-bare, diskoteka, nuk mund të ndikojmë as tek numri i madh i bastoreve dhe lojërave të fatit, porse mundemi dhe duhet të kujdesemi, si dhe të dimë se ku i kemi fëmijët, ku sillen ata dhe me

çfarë ushqehen ata. Kujdesi ynë ndaj tyre duhet të jetë i vazhdueshëm dhe këmbëngulës.

Të rinjtë e sodit, gjithnjë e më shumë, po varen nga kumarllëku, alkooli, droga, e sidomos nga prostitucioni, që vije si rezultat i takimeve, që me gjuhën moderne njihen si "takime rinore", ku dëfrimi dhe shfrenimi është shpërfaqja më dalluese atyre takimeve.

Të dashur prindër, nëse jemi të vetëdijsëm për përgjegjësinë që do të kemi në Ahiret për fëmijët tanë, atëherë duhet shpesh të pyetemi, sa herë që nuk do t'i kemi parasysh: ku dhe me kë shoqërohen fëmijët tanë?

Në këtë kohë të turbullirave dhe fitneve të mëdha, duhet të kemi kujdes edhe për një fakt tjetër, e që, ndonëse e dimë se ku janë, nuk e dimë se me kë shoqërohen. Kush i mëson dhe çfarë? Prindi i respektuar mendon se fëmijën e ka në xhami, në një vend të sigurt, e ndërkohë nuk i intereson nëse ajo xhami është legjitime, apo se cilët njerëz e udhëheqin dhe e kontrollojnë atë? Nuk i intereson aspak të di se cili është vizioni i asaj xhamie? Etj.

Gjithashtu, të dashur xhemat, edhe atëherë kur të mendojmë se fëmijët i kemi në shtëpi, edhe atëherë duhet të pyesim se me kënd janë? Sipas hulumtimeve më të reja, tregohet se në një familje, prindi dhe fëmija, nuk e kalojnë kohën së bashku më shumë se një orë në ditë. Të rinjtë e sodit kohën e kalojnë në internet, në rrjetet sociale, kurse në to, rrjetën e devijimit e ka lëshuar çdo dorë e keqe dhe devijuar. Andaj le të kemi kujdes se në dorën e kujt e kemi lënë pjesën më të çmuar të jetës dhe fesë sonë.

Të rinjtë tanë në internet, në rrjetet sociale, mund të mësojnë gjëra

të dyshimta, nga individë dhe thirrës të papërgjegjshëm, të cilët për synim kanë radikalizimin e të rinjve tanë dhe mësimin e Islamit të devijuar. Me çfarë imponimesh ballafaqohen sot të rinjtë tanë? Ata sot ballafaqohen me prioritete që aspak nuk i bëjnë dobi individit dhe Ummetit në përgjithësi. Të rinjtë tanë, në xhamitë tona, më shumë mësojnë për historinë dhe ngjarjet në Siri, Irak, e gjetiu, sesa që mësojnë për historinë dhe gjendjen e vendit të vet ku ata jetojnë.

Të dashur vëllezër, duhet shumë seriozisht ta marrim kërcënimin që vjen nga ndikimet e huaja që mund ta dëmtojnë rëndë të ardhmen tonë.

Allahu ynë i Lartësuar na tërheq vërejtjen në Kur'anin fisnik, duke na thënë:

“O ju që besuat, ruajeni veten dhe familjen tuaj prej një zjarri, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. Atë (zjarrin) e mbikëqyrin engjëjt e rreptë e të ashpër që nuk e kundërshtojnë All-llahun për asgjë që Ai i urdhëron dhe punojnë atë që janë të urdhëruar.” (Tahrim, 6)

Tani, më lejoni, me ca fjalë t’u drejtohem vetë të rinjve. Ju e dashura rini, nëse do të donim që të jemi krenaria e prindërve tanë në të dy botët, dhe nëse do të donim të bëheshim të dobishëm si për Ummetin, ashtu edhe për veten tonë, atëherë duhet të shoqërohemi më shumë me librin, të ndjekim më tepër rrugët e shkollës dhe të mektebit, të mësojmë në shkollë, në shtëpi, në xhami, të merremi me gjera të dobishme, sikur që është sporti, aktivizimi në ndonjë organizatë joqeveritare, kështu që të mund të bëhemi pjesë e ndryshimit pozitiv në shoqëri, dhe temat e rënda fetare le t’i lëmë të trajtohen nga ekspertët dhe përgjegjësit e fesë.

Besoj se ju të gjithë pajtoheni me mua, që edhe pas tërë këtyre viteve e shekujve, sërish u kthehemi dhe merremi me temat se a është haram muzika apo jo? Lëshimi i mjekrës a është farz apo sunet? Të mos flasim



se sa është duke u harxhuar koha duke diskutuar rreth asaj se a duhet të ngriten duart dhe sa duhet të hapen këmbët gjatë faljes së namazit.

Vallë ku mbeti diskutimi mbi vlerën dhe rëndësinë e leximit, mbi luftën ndaj korrupsionit dhe ndaj të këqijave të tjera që po e zhdukun Ummetin? Ku mbeti diskutimi mbi përgjegjshmërinë dhe sjelljen që duhet të ushtrojmë në vendet e punës dhe në ambientet publike? A e dinë të rinjtë tanë se modestia imanore është më e thellë se sa sexhdeja dhe më e gjërë se xhamia?

Le ta shtrojmë çështjen pak më globalisht dhe le të shohim se çfarë i ofroi njerëzimit Ummeti ynë gjatë njëqindvjeçarit të fundit? I kemi ofruar naftë, gaz, flori, pambuk, e gjëra të tjera nga resurset natyrore, do të thoshit ju. Qëllimi i pyetjes nuk është këtu, por te ajo se çfarë ka ofruar mendja muslimane në fushën e të arriturave shkencore teknologjike, si përgjigje ndaj urdhrorit kuranor për të lexuar “Ikre”.

Për fat të keq, sot në botë më shumë njihemi për nga nargjileja, doner kebapi, kërcimet valltare, dhe për nga qindra e mijëra emigrantë, të cilët po mbyten nëpër thellësitë e deteve, duke kërkuar një jetë më të mirë dhe duke ikur nga konfliktet ndërmuslimane.

Sërish, dëshiroj të pyes se a e dimë vërtetë ku dhe me kë shoqërohen fë-

mijët tanë? Nëse janë në shkollë, në fakultet, në xhami, në punë dhe në vende të hajrit, dhe kur të jenë të shoqëruar me mësues të ndershëm, që kanë nijet të pastër, të cilët do t’i mësojnë për rrugën mesatare, për atë se si duhet të jetohet për fenë dhe atdhenë, e jo për ndonjë interes personal apo grupor, atëherë dije vëlla dhe motër e ndëruar, se do të ecim përpara dhe do të ofrojmë shumë më shumë për njerëzimin.

Për fund dëshiroj të potencoj edhe një fakt nga historia jonë e lavdishme që flet për faktin sesa përparimtarë në kohë ishin muslimanët e parë. Kur udhëheqësi i muslimanëve, Xhafer El-Mensuri, i dërgoi një orë mbretit të Siçilisë, ky i fundit ishte habitur pasi që nuk kishte parë, e as që kishite dëgjuar për një mjet të tillë.

I riu i sodit duhet, gjithsesi, të kap hapin e të parëve dhe të qëndrojë fuqishëm dhe gjithmonë një hap përpara kohës.

Për fund, dua të jap edhe këtë porositi: i dashuri prind, kape evladin tënd për dore dhe fute në Xhennet, mirëpo, dije që, dera e xhenetit në këtë botë është, në radhë të parë, dera e xhamisë.

Zoti i Madh na ndihmoftë dhe na e udhëzoftë rininë tonë! Amin!

*(Hytbeja e xhumasë,
mbajtur në xhaminë "El-Hidaje"
në St. Gallen të Zvicrës,
më 23.05.2014)*

MYFTIU PRITI KËSHILLTARIN PËR ÇËSHTJE FETARE TË AMBASADËS SË TURQISË

Paraditën e së mërkurës, më 16 prill 2014, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, priti në një takim të përzemërt Këshilltarin për Çështjet Fetare në Ambasadën e Turqisë në Tiranë, z. Shaban Ishlek.

Objekt i këtij takimi ka qenë edhe bashkëpunimi i Dijanetit të Turqisë me Komunitetin Mysliman të Shqipërisë, Myftininë Shkodër.

Në këtë kuadër, është rënë dakort që në Shkodër, më 27 prill 2014, do të zhvillohet një simpozium me temë: "Hz. Muhammedi (a.s) dhe sinqeriteti në Islam". Referues në këtë simpozium do të jetë edhe Myftiu i Ankarasë, si dhe imami i një prej

xhamive kryesore të kryeqytetit të Turqisë.

Gjatë këtij takimi, është folur edhe për prag-përfundimin e xhamisë së fshatit Barbullush, si sponsorizim i Myftinisë së Iskenderunit (Turqi), ku z. Ishlek ka një kontribut të vyer dhe shumë me vlerë në arritjen e marrëveshjes për financimin e kësaj xhamie të re dhe mëse të domosdoshme për Myftininë Shkodër.

Myftiu i Shkodrës e ka falënderuar z. Shaban Ishlek për kontributet e deritanishme dhe bashkëpunimin e frytshëm me Myftininë Shkodër, duke e konsideruar si një mik të mirë dhe vëlla të singertë.

FUSHATË SENSIBILIZIMI PËR XHAMITË NË NEVOJË

Paraditën e së enjtes, më 17 prill 2014, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, ka zhvilluar një takim me imamët e qytetit dhe të disa zonave, në një takim mbi nevojën e sensibilizimit të masës muslimane me nevojën e madhe që kanë shumë xhami të Shkodrës për rikonstrukcion, lyerje dhe pajisje me minaret.

Fillimisht, Myftiu ka prezantuar listën e xhamive që kanë nevojë për ndihmë të shpejtë, si: Xhamia e Parrucës (*lyerje dhe tapet të ri*), xhamia "Ebu Bekër" (*tapet të ri*), xhamia e Tophanës (*lyerje dhe meremetime*), xhamia e Kirasit (*meremetim dhe lyerje e jashtme*), xhamia Xhaferajve (*minare*), xhamia e Bardhejve (*minare*), xhamia e Omarajve (*minare*), xhamia e Shtufit (*minare*), xhamia e Milanit (*minare*), xhamia e Anës së Malit (*klasë për fëmijët e xhamisë*) etj.

Me këtë rast, Myftiu ka shpallur fushatën dyjavore të mbledhjes së fondeve, në kuadër të kësaj ndërhyrje në ndihmë të xhamive të qytetit

dhe fshatit.

Njëkohësisht në këtë takim është prezantuar edhe projekti i mbrëmjeve fetare në xhami të qytetit dhe të fshatit, sipas këtij programi:

21 prill 2014: Xhamia Perash, ligjërues: teologu Gilman Kazazi dhe teologu Lavdrim Hamja.

22 prill 2014: Xhamia e Medresesë, ligjërues Imam Muhamed Sytari dhe teologu Arben Halluni.

23 prill 2014: Xhamia e Bardhejve, ligjërues teologu Adem Pizga dhe teologu Ervil Kuçi.

28 prill 2014: Xhamia Rus, ligjërues teologu Idmir Plaku dhe teologu Durim Kasemi.

29 prill 2014: Xhamia Tophanë, ligjërues Imam Muhamed Sytari dhe teologu Ruzhdi Plangaj.

30 prill 2014: Xhamia Golem, ligjërues teologu Lavdrim Hamja dhe teologu Naim Drijaj.

Këto mbrëmje fetare do të organizohen pas namazit të akshamit.

"Zogjtë
që linden
në kafaz,
besojnë
se fluturimi
është krim".

(arabe)



MYFTIU BËN THIRRJE PËR SENSIBILIZIM ME XHAMITË NË NEVOJË

Nga xhamia e fshatit Oblikë, të xhumanë, më 18 prill 2014, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, ka bërë thirrje për mbledhje fondesh bamirëse, në shërbim të disa xhamive në Shkodër, të cilat kanë nevojë për ndërhyrje të menjëhershme.

Duke shpalosur iniciativën më të re të Myftinisë Shkodër: "Ndhim për xhaminë time", Myftiu ka theksuar se në harkun e dy javëve, do të bëhen thirrje në të gjitha xhamitë e Shkodrës për të kontribuar në vlera monetare, për të ndihmuar xhamitë që kanë nevojë për ndërhyrje rikonstruksioni, për ndryshim tapeti, për ndërtim minareje etj.

Me këtë rast, Myftiu ka informuar të pranishmit për takimin e një dite më parë me imam të qytetit dhe fshatit, me të cilët ka ndarë idenë e kësaj iniciative. Më pas, ka përmendur disa nga xhamitë që kanë nevojë për ndërhyrje, si: Xhamia e Parrucës (*lyerje dhe tapet të ri*), xhamia "Ebu Bekër" (*tapet të ri*), xhamia e Tophanës (*lyerje dhe meremetime*), xhamia e Kirasit (*meremetim dhe lyerje e jashtme*), xhamia Xhaferajve (*minare*), xhamia e Bardhejve (*minare*), xhamia Fshati i Ri (*minare*), xhamia e Omarajve (*minare*), xhamia e Shtufit (*minare*), xhamia e Milanit (*minare*), xhamia e Anës së Malit (*klasë për*

MYFTIU I ANKARASË, PËR VIZITË NË SHKODËR

Paraditën e së dielës, më 27 prill 2014, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, priti në një takim vëllazëror, Myftiun e Ankarasë, nga Republika e Turqisë, prof. dr. Mefail Hizli, që shoqërohej edhe nga Këshilltari për Çështjet Fetare në Ambasadën e Turqisë, z. Shaban Ishlek.

Fillimisht, Myftiu i Shkodrës, ka shprehur kënaqësinë e tij për vizitën e Myftiut të kryeqytetit të Turqisë, në Shkodër, duke e konsideruar si vlerësim për Myftininë e Shkodrës. Myftiu ka kujtuar edhe vizitën e paharruar në Shkodër, të Kryetarit të Dijanetit të Turqisë, prof. dr. Mehmet Gormez, vitin që kaloi.

Edhe Myftiu i Ankarasë, ka vlerësuar se Shkodra është një ndër qytetet më tërheqëse, që ka vizituar në udhëtimet e tij të shumta, duke

fëmijët e xhamisë), xhamia Guri i Zi (*rikonstruksion*) etj.

Më parë, në një bashkëbisedim para namazit të xhumasë, Myftiu ka falënderuar hoxhën e moshuar të kësaj xhamie, Hafiz Musa Hoxha, për prezencën e tij në mesin e besimtarëve dhe shembullin personal në shërbim të Thirrjes Islame dhe vlerave të saj.



nisur nga pozitiviteti që reflektojnë banorët e saj e deri te historia dhe kultura e pasur. Prof. Hizli, ka përmendur se kjo është vizita e tij e katërt në Shqipëri, e para si Myfti i Ankarasë, në kuadër të aktiviteteve të përbashkëta fetare në mes të dy vendeve.

Gjatë takimit është folur edhe për mundësitë e shumta që janë lehtësuar sot, për ta shtuar bashkëpunimin në fusha të ndryshme, në mes të dy komuniteteve islame të vendeve tona.

Me rastin e kësaj vizite, Myftiu i Ankarasë, do të jetë ligjërues në simpoziumin me temë: "Profeti Muhammed (a.s) dhe sinqeriteti në Islam", që zhvillohet si pjesë e bashkëpunimit të Zyrës së Këshilltarit për Çështje Fetare në Ambasadën e Turqisë, me Komunitetin Mysliman të Shqipërisë dhe Myftinitë e ndryshme të saj.

Me rastin e kësaj vizite, janë këmbyer edhe dhuratat e rastit. Ndërkohë, për nder të mikut të tij, Myftiut të Ankarasë, Imam Muhamed Sytari, ka shtruar një drekë vëllazërore.



AKTIVITETI: "PROFETI MUHAMMED (A.S) DHE SINQERITETI NË ISLAM"



Ditën e dielë, më 27 prill 2014, Myftinia Shkodër në bashkëpunim me Zyrën e Këshilltarit për Çështjet Fetare në Ambasadën e Republikës së Turqisë, kanë organizuar një aktivitet fetar me temë: "Profeti Muhammed (a.s) dhe sinqeriteti në Islam", ku ka ligjruar Myftiu i Ankarasë, prof. dr. Mefail Hizli.

Aktiviteti nisi me këndimin e disa pjesëve kur'anore, nga hafizi i mirënjohur turk, H. Ahmed Karali, imam i xhamisë "Haxhi Bajram Veli", në Ankara.

Më pas, teologu Arben Halluni, pasi ka uruar mirëseardhjen e miqve dhe të ftuarve, ka theksuar se ky aktivitet është pjesë e një cikli ligjëratash, që organizohen në vazhden e bashkëpunimit që Zyra e Këshilltarit për Çështjet Fetare në Ambasadën e Republikës së Turqisë, ka me Komunitetin Mysliman të Shqipërisë

dhe në rastin e sotëm me Myftininë Shkodër.

Në fjalën e tij të përshëndetjes, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, ka përshëndetur prezencën në Shkodër të Myftiut të Ankarasë, prof. dr. Mefail Hizli, duke vlerësuar se organizime të tilla, kanë vlera dhe dobi për besimtarët dhe bashkësinë e muslimanëve në Shkodër dhe përtej saj.

Në fjalën e tij, Myftiu u ndal te një mesazh i rëndësishëm në jetën dhe shembullin e Hz. Muhammedit (a.s); sinqeriteti dhe vendosmëria në shërbim të Thirrjes Islame. Në këtë kontekst, Myftiu rrëfeu ngjarjen e Taifit, ku edhe pas refuzimit dhe dëbimit që iu bë të dërguarit të All-llahut, ai, në qetësi, iu drejtua Zotit, duke i dëshmuar bindjen dhe vendosmërinë e tij, nëpërmjet një lutje të rrethuar nga sinqeriteti dhe emocionet.

Myftiu ka ripërsërirur se sfidat e

përditshme, me të cilat përballen muslimanët në Shkodër dhe në Shqipëri, kërkojnë më shumë se asnjëherë tjetër, ndjekjen e shembullit të Hz. Muhammedit dhe veshjen me sinqeritet e vendosmëri.

Më pas, aktiviteti ka vijuar me përshëndetjen në emër të Kryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, që është bërë nga nën/kryetari, z. Gazmend Aga.

Në fjalën e tij, ai ka folur mbi altruizmin, duke theksuar se prej sinqeritetit është që njeriu të vendosë vëllanë para vetes dhe interesin e gjerë mbi atë të ngushtë, në jetë.

Atasheu turk, z. Shaban Ishlek, në përshëndetjen e tij, ka vënë theksin te rëndësia që kanë aktivitetet që bashkojnë njerëzit në tryezat e besimit dhe forcojnë vëllazërinë islame, nëpërmjet këtyre vizitave të shtrenjta dhe aktivitetëve me dobi.

Me shumë kënaqësi, të pranishmit kanë ndjekur ligjëratën e mbajtur nga Myftiu i Ankarasë, prof. dr. Mefail Hizli. Në qendër të saj, Myftiu ka shpjeguar hadithin profetik: "Feja është këshillë" me pesë degëzimet e saj, si në fjalën e Profetit (a.s).

Myftiu ka shprehur kënaqësinë e tij që gjendet sot në Shkodër, duke e vlerësuar këtë udhëtim si pjesë të shprehjes së dashurisë dhe vëllazërisë që muslimanët kanë më njëritjetrin. Për këtë, ai ka nxitur shtimin e harmonisë dhe vëllazërisë në mesin e muslimanëve, në shembullin e Hz. Muhammedit (a.s) dhe sahabëve të tij.



MËSHIRË PËR KRIJESAT

Islami e mëshiron dobësinë njerëzore, gabimtarit i jep shanse për t'u penduar dhe devijuesit për t'u drejtuar. Të bësh njerëzit të dëshpërohen prej mëshirës së Allahut është krim, ndërsa edukatori i drejtë hap dritaret e shpresës për devijuesit derisa ata të kthehen te Zoti i tyre.


Disa thirrës, sikur ata të jenë caktuar roje të gabimtarëve, i fajësojnë, i zbulojnë dhe ua zënë frymën!! Më mirë për ta do të ishte të sillen me mëshirë derisa t'i drejtojnë në rrugën e shpëtimit tek Allahu dhe nënshtrimit ndaj Tij, sepse Allahu meriton çdo dashuri.

Transmeton Nesaiu se një njeri

dy melekë e së bashku me të shkuan në një qytet. Trokitën në portën e qytetit dhe dera u hap. Hynë brenda dhe panë disa burra, gjysma e tyre ishte në formën më të bukur, ndërsa gjysma tjetër në pamjen më të shëmtuar që mund të shikojë një njeri. Dy melekët u thanë: Shkoni dhe hidhuni në lumë. Uji i lumit përballë ishte i bardhë safi. Ata u hodhën në të, pastaj u kthyen dhe gjithë shëmtimi ishte larguar prej tyre e morën pamjen më të bukur... "!!

Dy melekët ia komentuan pamjen Pejgamberit (a.s) duke i thënë: "*Këta njerëz kanë përzier punë të mira me punë të këqija dhe Allahu ua ka falur atyre!*"

Hadithi është i transmetuar te Bu-



Sheikh Muhamed El-Gazali

net të mirë, të cilët i kanë kapluar humbjet, edhe po qe se ato janë shumë, ndërsa njerëzit me vullnet të ndërlikuar me gjynahin, puna e tyre është ndryshe.

Pastaj, ai që mohon Allahun, apo refuzon sheriatin e Tij, ai që në fillim është i larguar nga hapësira e magfiritit (mëshirës). Sepse, kur mohon detyrat, lejon haramet (të ndaluarat) dhe guxon ndaj Madhërisë së Zotit, ai nuk do të korrë, vetëm se një të ardhme të zyrtë.

Ka thirrës që janë mjekues plagësh dhe i dëshirojnë shërimin të sëmurit. Ia shtrojnë rrugën e hajrit (të mirës) me lule dhe i buzëqeshin çdokujt që shkel në ata rrugë. Nëse dikujt i rrëshqet këmba e ndihmojnë për tu ngritur dhe ia ndreqin gjendjen, derisa të rinisë sërish rrugëtimin, krenarë dhe i mbrojtur.

Por, ka edhe të tjerë thirrës, që nuk dëgjon prej tyre, veçse mjerim, kërcënim dhe shkatërrim!

Si të thuash, ata a janë më xhelozë për fenë, se sa Zoti i fesë? Apo janë më të mëshirshëm për njerëzit, se sa Zoti i njerëzve?

Mëshirë për krijesat dhe le të kujtojmë transmetimin e butësisë "*Njerëzit janë dy llojesh, i sprovuar dhe i shëruar. Prandaj, mëshironi njerëzit e sprovuar dhe falënderoni Allahun për shërimin (shëndetin) tuaj!*"

Përktheu nga arabishtja:

Lavdrim Hamja



kurrë nuk kishte punuar asnjë të mirë, por u jepte borxh njerëzve. Ai i thoshte shegertit të tij: Merru sa munden të paguajnë, lëri kur janë në vështirësi dhe falua, sepse ndoshta Allahu na fal edhe neve!!

Kur ai vdiq, Allahu e pyeti: A ke punuar kurrë ndonjë të mirë? - Jo, përveçse kam pasur një shegert dhe u jepja borxh njerëzve. Kur atë e dërgoja për të mbledhë borxhet, i thosha: Merru sa munden të paguajnë, lëri kur janë në vështirësi dhe falua, sepse ndoshta Allahu na fal edhe neve!! Allahu i Madhëruar i tha: Patjetër që të kam falur edhe ty...

Transmetohet në ëndrrën e vërtetë të Pejgamberit (a.s) se: "*Ndërkohë që ai ishte në gjumë erdhën dhe e morën*

hariu dhe Muslimi dhe vërtetësinë e tij e kam hasur disa herë në Librin e Allahut: "*Dhe të tjerë që pohojnë për gjynahet e tyre, kanë përzier punë të mira me të tjera të këqija. Ndoshta Allahu ua pranon pendimin e tyre. Me të vërtetë, Allahu është Falës dhe Mëshirues...*" (Teube, 102), e shpresë-lutja tek Allahu është e pranueshme!

Përsëri, Allahu (xh.sh) thotë: "*Ata që kanë besuar dhe kanë bërë vepra të mira, patjetër Ne do tua fshijmë atyre të këqijat dhe do t'i shpërblejmë ata me më të mirën e asaj që kanë punuar.*" (Ankebutë, 7). Duket qartë prej krahasimi të ajeteve, të premtimit dhe dënimit se dyert e shpresës janë të hapura për njerëzit me vull-

ALL-LLAHUT I ANKOHEMI| PËR VAKËFIN TONË NË ZDRALEJ!

Vonesat dhe mos realizimi i ndërhyrjes së lajmëruar zyrtarisht nga INUV-Bashkia Shkodër për ndërhyrjen e shembjes së një objekti pa leje në pronën e Myftinisë Shkodër në Zdralej, ditën e martë, më 29 prill 2014, është dështimi i radhës i INUV në raport me detyrimin që ka ndaj Myftinisë Shkodër prej vitesh.

Ndonëse ishim lajmëruar me shkresë zyrtare nga INUV- Bashkia Shkodër, për ndërhyrjen që do të bëhej për prishjen e këtij objekti të paligjshëm në tokën tonë vakëf, në Zdralej, ndërhyrja nuk u bë.

Përfaqësuesit e Bashkisë, thonë se nuk i ka mbërritur lajmërimi personit uzurpues, që prej vitesh mban peng

truallin e Myftinisë Shkodër, duke shkaktuar dëme ekonomike për mosmundësimin e shfrytëzimit tonë të vakëfit të shenjtë.

Mirëpo, prej informacioneve të sakta që kemi, personit në fjalë i ka mbërritur lajmërimi zyrtar, pasi gjatë kësaj jave ai është ankuar edhe në Komunitetin Mysliman të Shqipërisë, në Tiranë, por edhe në vetë zyrën e INUV- Bashkia Shkodër!?

Pyetja që shtrojmë është: Kur konsiderohet i lajmëruar ky person, që na ka mbajtur peng vakëfin e shenjtë, edhe me ndihmën e disa deputetëve të Shkodrës dhe ndërhyrjeve politike, të njëjtat që na kanë mbajtur peng edhe vakëfin e shenjtë në Zogaj, kur porositë për moszbatimin e

pastrimit të pronës së uzurpuar, janë dhënë nga Shkodra!?

Për informacionin e të interesuarve, kjo godinë në Zdralej, duhej të ishte prishur që në vitin 2005, por për ndërhyrjet e paskrupullta të politikës në Shkodër dhe Tiranë, vakëfinë u mbajt peng për 9 vite!

All-llahut i ankohemi për vakëfin tonë, Atij i ankohemi për të gjithë ata që u bënë shkak që zaptimi i vakëfit të vazhdonte deri në këtë kohë!

Kujdes, nuk ka si lutja e atij që i është bërë padrejtësi dhe është tallur me shenjtëritë e tij!

Ka Një Zot, i Cili është i Plotfuqishëm dhe i përgjigjet lutjes së atij që i është shkelur e drejta!





**"Nëse nuk paqtohet njeriu
me Krijuesin e tij,
duke iu nënshtruar Atij në jetë,
s'do të ketë PAQE mbi tokë."**

- Shejkh Ahmed Keftaro

MYFTIU: "MË SHUMË BASHKËPUNIM NË MESIN E MUSLIMANËVE!"

Të xhumanë, më 2 maj 2014, nëpërmjet minberit të xhumasë në xhaminë e fshatit Mes-Myselim, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari ka bërë thirrje për më shumë bashkëpunim dhe solidarizim në mesin e muslimanëve.

Thirrja ka ardhur në kontekstet e hytbes, mbi rëndësinë dhe vlerën e dhënies së selamit në mesin e muslimanëve. Nga këtu, Myftiu ka tërhequr vëmendjen e besimtarëve duke thënë se: "Ne muslimanët kemi zakonet tona, traditat dhe trashëgiminë më të pasur e më të pastër, pas së cilës duhet të kapemi, ne dhe fëmijët tanë. Nuk kemi nevojë të adaptojmë zakone dhe tradita joislame, që nuk kanë lidhje me ne dhe besimin tonë.

Nga këtu, më lejoni të tërheq vëmendjen tuaj rreth një fakti që e shohim dhe e dëshmojmë thujtë ditë pas dite. Njerëzit, duket se po druhen të japin e të marrin selamin në mes vete!? Përse?

Vëllezër, ne jemi muslimanë dhe nuk kemi pse i druheni askujt, sepse ajo çfarë na ka ardhur nga i dërguari

i All-llahut është dritë dhe udhëzim për mbarë njerëzinë.

Mos u gënjeni pas thirrjeve shterpë të disave, që ju servirin nëpërmjet mediave një model që nuk është modeli i fesë sonë, sepse fenë e kemi gjënë më të shtrenjtë në jetë!

Jepeni selamin dhe merreni selamin pa ndrojtje, pa frikë, pa menduar se dikush ju shikon me sy të shtrembër! Ne nuk jemi pakica kombëtare në këtë vend, jemi shqiptarë të ndershëm dhe muslimanë të lindur, e që

trashëgojmë besimin dhe fenë tonë brez pas brezi!

Nëse komunizmi nuk arriti të na e çrrënjosë besimin dhe fenë, mos të lejojmë të na e bëjë ajo që e pasoi komunizmin në këtë vend dhe ithtarët e tyre!"

Gjatë hytbes së kësaj xhumaje, Myftiu ka bërë thirrje që muslimanët të punojnë më shumë për njëri-tjetrin dhe të mos tolerojnë asnjë iniciativë kundër vëllezërve të tyre muslimanë, nga kushdo qoftë e sido që të jetë!





MBYLLET I LIGJËRATAVE

Në datat 21,22,23 – 28,29,30 prill 2014, Myftinia Shkodër organizoi ciklin e parë të ligjëratave fetare pas namazit të akshamit, në xhami të ndryshme të qytetit dhe të fshatit, ku ligjëruan Myftiu dhe imamë të ndryshëm teologë.

Sipas një programi të paralajmëruar, cikli i parë i ligjëratave pas akshamit përfshiu xhamitë e mëposhtme, sipas këtij programi:

21 prill 2014: Xhamia Perash, ligjëruan: teologu Lavdrim Hamja dhe teologu Gilman Kazazi.

22 prill 2014: Xhamia e Medresesë, ligjëruan teologu Arben Halluni dhe Imam Muhamed Sytari.

23 prill 2014: Xhamia e Bardhejve, ligjëruan teologu Adem Pizga dhe teologu Ervil Kuçi.

28 prill 2014: Xhamia Rus, ligjëruan teologu Idmir Plaku dhe teologu Lavdrim Hamja, që zëvendësoi teologun Durim Kasemi.



CIKLI -I- PAS AKSHAMIT

29 prill 2014: Xhamia Tophanë, ligjëruan Imam Muhamed Sytari dhe teologu Ruzhdi Plangaj.

30 prill 2014: Xhamia Golem, ligjëruan teologu Lavdrim Hamja dhe teologu Naim Drijaj.

Gjatë këtyre ligjëratave, u trajtuan tema të larmishme, si: “Mirësjellja në mesin e muslimanëve”, “Vlera e kohës tek dijetarët muslimanë”, “Vëllazëria dhe solidarizimi në jetën e muslimanëve”, “Namazi dhe dua ja në jetën e besimtarit”, “Mirënjohja dhe falënderimi në jetën e muslimanëve”, “Përkushtimi i sahabëve në fe”, nëpërmjet të cilave u synua gjallërimi i jetës fetare në xhamitë e ndryshme të Shkodrës dhe përfitimi nga trajtesat e specializuara të imamëve teologë.

Me mbarësinë e All-llahut, cikli i ligjëratave pas namazit të akshamit do të vazhdojë edhe më tej në xhami të tjera, sipas një programi që do të bëhet publik nga Myftinia Shkodër.



AKTIVITET PËRKUJTIMOR MBI VEPRËN E DIJETARIT HAFIZ HALID BUSHATI



Pasditën e së enjtes, më 8 maj 2014, Myftinia Shkodër organizoi një aktivitet shkencor, në përkujtim të dijetarit të shquar islam shkodran, Hafiz Halid Bushati (? – 1916).

Aktiviteti, që u zhvillua në ambientet e bibliotekës së qytetit, nisi me referatin e teologut Naim Drijaj, që bëri një përshkrim të momentëve më të spikatura nga jeta e këtij dijetari të shquar. Në jetëshkrimin e prezantuar para të pranishëmve, u theksua lidhja e këtij dijetari me xhaminë, fetvanë dhe bibliotekën, si pjesë e pandarë e aktivitetit të tij të spikatur.

“Urtësia, matura, autoriteti, kom-

petenca e drejtësia e tij, të bazuara në mësimet islame, u jepnin rrugë nevojave e halleve të njerëzve, bënin jehonë, rritnin figurën e tij fetare, qytetare e njerëzore.” – tha referuesi.

Një analizë të gjerë të dorëshkrimeve dhe gjurmëve shkencore të trashëguara nga H. Halid Bushati, e ka zhvilluar në referatin e tij, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari.

“Në hulumtimet e mia rreth personalitetit dhe gjurmëve diturore të dijetarit Hafiz Halid Bushati, më tërhoqi vëmendjen një shënim anësor me shkrim dore, në brendësinë e një libri të vjetër në gjuhën arabe, në të

cilin dëshmohej se: “Besimtari arrin në gradën e miqësisë me All-llahun me një nga këto tri rrugë: duke lexuar në librat e të parëve, ose të dojë për hir të All-llahut, ose të ketë një prijës murshid”.

Të trija këto tri stacione drejt lartësimit në marrëdhënie me Zotin, që reflektojnë në jetën e përditshme të besimtarit, në shoqëri, i kam gjetur dhe evidentuar në ato pak gjurmë cilësore, që koha i ka ruajtur në botën e sekreteve të saj të çmuara, për llogari të dijetarit H. Halid Bushati.” – ka thënë Myftiu.

Aktiviteti ka vijuar me një vështrim kushtuar Hoxhës H. Halid Bushati, nga H. Fejzi zaganjori, që ka përshëndetur këtë iniciativë të Myftinisë Shkodër për vazhduar me aktivitetin e saj në nderim të dijetarëve dhe hoxhallarëve të shquar të Shkodrës.

Me shumë emocion, në emër të familjes Bushati, ka përshëndetur nipi i H. Halid Bushatit, shkrimtari Xhahid Bushati, që përveç falënderimeve për organizatorin, ka shpalosur edhe disa kujtime dhe emocione që lidhen me emrin dhe kujtimin e dijetarit H. Halid Bushati.

Me rastin e këtij aktiviteti, Myftiu i Shkodrës i ka dhuruar z. Xhahid Bushati dhe bibliotekës së Shkodrës, nga një foto të vulës dhe kaligrafisë arabe të këtij dijetari të nderuar islam shkodran.



Khahid Bushati, shkrimtar
Nipi i Hoxhës, H. Halid Bushati

DIJETARËT MES LIBRAVE, NJË DITË KTHEHEN VETË NË LIBËR...

(Përshëndetja me rastin e veprimtarisë kushtuar Hafiz Halid Bushatit)

Të nderuar të pranishëm, Selamun Alejkum

Kjo veprimtari në nderim të gjyshit tim Hafiz Halid Bushati, nga ana e Myftinisë së Zonës Shkodër, është shenjë vlerësimi dhe mos-harrimi për kontributet e rëndësishme të hoxhallarëve dhe të dijetarëve në fushën e Islamit. E, kjo veprimtari, që në dukje të parë ngjan si e thjeshtë, por në vetvete ajo është kuptimplote dhe mbart një mision të rëndësishëm: një periudhe historike apo një dekadë vitesh, i heq errësirën e harrimit dhe një figure pluhurin e saj, pra dritëson kujtesën si domosdoshmëri, dhe kjo dritë është e pranishme në bashkëkohësi. Pastaj, kjo merr dimensione kualitative nga analiza e hollësishme, me një semantikë poetike, përmes një hulumtimi të vëmendshëm, të bërë me shumë zotësi e profesionalizëm nga ligjëruesi Imam Muhamed Sytari për librin e gjyshit tim. Përmes interpretimeve të librit na e solli të gjallë Hafiz Halid Bushatin, që me siguri ka për t'i thënë diçka kësaj kohe nga dituria e tij. Unë e falenderoj ligjëruesin, i cili në rrugën e Thirrjes Islame, çdo herë na sjell mesazhe të rëndësishme e jetike për problematikën e jetës që jetojmë.

Gjithashtu dua të falënderoj imamët Fejzi Zaganjori, Naim Driaj dhe teologun Arben Halluni për fjalët që thanë në vlerësimin e figurës së gjyshit tim.

Libri që mban për autor Hafiz Halid Bushatin, dhe është i pajisur me shumë fusnota, pra që ka marrë dije edhe nga libra të tjerë, i flet një kohe, një psikologjie, një realiteti, ca fenomeneve, etj.; është kronikë dhe memorie e saj. Është shkruar me dorën e

tij, dhe relikja ku ai ka mbajtur bojën dhe penën, unë e kam të dashur e të shenjtë dhe e mbaj mbi tavolinën tim të punës, si diçka të vyer e si amanet. Po ashtu siç mbaj fotografinë e tij dhe tespihet e tij.

Për përmbajtjen dhe vlerat e librit foli, siç e thashë, Imam Muhamed Sytari. Por... ky libër ka një histori të vogël. Dhe historia lidhet me ruajtjen e tij, ndryshe do të kishte humbur, ndryshe do të kishte rënë në ndonjë dorë të pasigurtë e dinake, ndryshe... e nuk do të ishte i gjallë, si një vatër drite, në mes nesh. E kjo falë mençurisë së nënës sime (që i çoj rahmet dhe qoftë

konsideronte miq të vërtetë. Tregojnë një herë... I erdhi për vizitë Hafiz Sheuqet Boriçi, një burrë sa i mençur aq dhe i ditur. Me të hyrë në bibliotekë, diku aty nga rreshtat e librave të raftit përballë, çuditërisht "lëviz" një libër. Gjyshi i thotë: "Hafiz Sheuqet, unë e di, pse ke ardhur. Pikërisht, për të më kërkuar atë libër që po "lëviz". Duke pranuar elementin mitik të kësaj historie, shkëlqen një e vërtetë, dijetarët mes librave, një ditë kthehen vetë në libër.

Gjyshi im kishte mik të ngushtë, mik amaneti Hafiz Halil Pukën. Aq të ngushtë e kishte, sa i la dhe amanetin e fundit, i cili ishte: "Të më varrosni në Xhaminë Plakë në Zdrale, ku është hoxhë Halil Puka. Fati e solli që për 40 vite të jetoj në lagjen Zdralej. Dhe deri në vitin 1967, unë e njoha se ku ishte varri i gjyshit tim, pastaj nuk e njoha më. Revolucioni famëkeq e njerëzve shpirtkëqinj e katilë kundër fesë, shkatërruan dhe varret...

Unë krenohem me gjyshin tim. Ashtu siç krenohet Gëzim Puka me gjyshin e tij Hafiz Halil Pukën. Unë me Gëzimin jo vetëm që ishim komshinj të mirë, por jemi dhe miq të mirë, ashtu si qenë miq gjyshërit tanë. Ndoshta, kështu përsëritet historia në vlera qytetarie përmes konteksteve të reja historiko-shoqërore.

Më lejoni, t'ju falënderoj të gjithëve! Nëpërmjet kësaj ekspozite dhe studimit të ligjëruesit, shpresoj se do ta njihni sadopak gjyshin tim të nderuar Hafiz Halid Bushatin.

Shpresoj, gjithashtu, duke u njohur me kaligrafinë e shkrimit të tij, miqësisht do t'u kërkoja "t'i çoni edhe një rahmet".



e xhenetit), e cila me shumë fanatizëm (në kuptimin pozitiv të fjalës) e ruajti thellë në baulen e saj, atje, thellë mes teshave të saj të nusërisë e të pleqërisë. Di që shumë e kërkuan këtë libër, di që edhe ca e kërcënuan për këtë libër... Ajo nuk u tremb, nuk u tërhoq, nuk u thye, si vlerë mëmësie që ishte, ruajti vlerën e librit të vjehrrit të saj, të cilin nuk e njohu.

Nëpërmjet kujtimeve të nënës sime, kam mësuar që vitet e fundit gjyshi im i kalonte pothuajse në bibliotekën e tij dhe falej në xhaminë e Perashit. Në bibliotekë priste miqtë, që ai i

MYFTIU: "O ZOT, UDHËZONA KREJTVË DREJT HARMONISË ISLAME!"

Ditën e xhuma, më 16 maj 2014, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, ka mbajtur hytben e tij të xhumasë në xhaminë e Koplikut, në Malësi të Madhe.

Në trajtesën e tij të kësaj jave, Imam Muhamed Sytari, ka folur mbi rëndësinë që ka harmonizimi i vep-ri-meve dhe kontributeve në mesin e muslimanëve shqiptarë, duke iu referuar 24 viteve të fundit, ku, siç ka thënë Myftiu: "Të shumta janë kontributet e dhëna nga donatorë të ndryshëm nga mbarë bota islame, në shërbim të rimëkëmbjes së trashëgimisë islame në vendin tonë gjatë kësaj periudhe, por, është koha që muslimanët shqiptarë të rikthehen tek traditat e baballarëve të tyre, të cilët janë dëshmuar përherë si bamirës! Vakëfet e shumta, për të cilat përpiqemi kaq shumë, për t'i rikthyer në identitet, janë dëshmia më e mirë e sinqeritetit të tyre; nuk i shoi dot komunizmi, s'e bën dot as postkomunizmi! Sepse ajo që është dhënë me sinqeritet, do të mbrohet, qoftë edhe pas 100 vitesh! Prandaj, unë ju ftoj sot që të zgjohemi e të mos shohim interesat e ngushta të shoqatave e fondacioneve, por të

bashkëpunojmë për të mirën e komunitetit tonë! Askush, nuk mund të bartë i vetëm barrën e kësaj Thirrje të shenjtë Islame, së bashku mund të bëjmë atë që pritet të bëjmë, e që akoma s'e kemi bërë si duhet, në hak të fesë dhe kohës sonë!"

Në hytben e tij, Myftiu i Shkodrës ka bërë lutje që All-llahu t'i japë udhëzimin e duhur Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Myftinive, imamëve, hatibëve dhe krejt faktorëve që shërbejnë sot në të mirë të Thirrjes Islame, për të mirën e kësaj feje të pastër islame.

Të pranishëm në faljen e kësaj xhumaje në xhaminë e Koplikut, ishin edhe: ambasadori i Kuvajtit, ambasadori i Libisë, atasheu për çështjet fetare në ambasadën e Turqisë, nën/kryetari i KMSH, myftiu i Tropojës, myftiu i Malësisë së Madhe, Myftiu i Hasit, drejtues të shoqatave të ndryshme islame që operojnë në Shqipëri etj.

Më herët, Myftiu i Zonës Shkodër, mori pjesë edhe në inaugurimin e Qendrës së re Islame të Koplikut, mbështetur nga Fondacioni "Mirësia", me donacione bamirëse nga Kuvajti.



PERDJA,
NUK ËSHTË ASGJË TJETËR
VETËM SE FILLI
QË NDAN ERRËSIRËN
E EGOIZMIT
NGA DRITA E LOGJIKËS
SË QETË.

PRANDAJ,
DUHET ME PASË KUJDES
PARA SE ME FOLË,
A ME GJYKU PËR DIKË
A DIÇKA...

Lulja e Prillit

(Profetit Muhamed a.s.)

*Kur ti i kyç ngjyrat, pemët dhe lagjet,
Më humbasin adresat e vjetra të botës,
Mandej zhytem zbrazëtime të mia,
Mes t'bardhës e t'zezës lëkundet jeta.*

*Kur rrezet e diellit
Prej teje nuk mbijnë,
Humbasin mëngjeset,
E koha hapsirash ngrin.*

*Kur ti hanën mban në dorë,
Nata ime mbushet me hir,
E shuhet koha, hapsira ikën,
E lind një lule n'prill...*

*Bletët e shikimeve të mia punojnë,
Në zgjua jeta hareshëm gumëzhin,
Sillen rreth teje plot dashuri,
Ti je për to e vetmja stinë.*

*Edhe zemrat si trupat e kanë një atdhe,
Në liqenin romantik të dijes notojnë,
Eja n'kuvendin e fjalëve, të bisedojmë
Pak në shqip e pak në heshtje...*

Alban Kali

MYFTIU PRITI AMBASADORIN E KUAJTIT, NAJEEB AL-BADER



Të xhumanë, më 16 maj 2014, Myftiu i Shkodrës, priti në një takim të përzemërt Ambasadorin e Shtetit të Kuvajtit, në Tiranë, z. Najebb Al-Bader, që shoqërohej edhe nga Ambasadori i Libisë, z. Isam Ferexh Ibn Xhelil.

Gjatë takimit, është diskutuar për frymën e bashkëpunimit dhe kontributet e shumta që populli kuvajtian ka dhënë për Shqipërinë, sidomos në dy dekadat e fundit. Me këtë rast, Myftiu i Shkodrës, ka falënderuar edhe angazhimin e z. Al-Bader për thellimin e këtij bashkëpunimi dhe rritjen e investimeve dhe donacioneve kuvajtiane në Shqipëri.

Bisedat në mes të Myftiu dhe ambasadorëve të nderuar, janë shtrirë edhe në trashëgiminë islame dhe gjurmët e dijetarëve islamë të

Shkodrës ndër vite, si një garanci për gjallërimin e mëtejshëm të Thirrjes Islame në Shkodër, nëpërmjet përkujtimit dhe ringjalljes së gjurmëve të tyre.

Bashkëbiseduesit kanë diskutuar edhe mbi mundësinë e bashkëpunimeve të dobishme, në shërbim të dijes, kulturës dhe besimit, në rrugën e forcimit të urave të bashkëpunimit dhe vëllazërisë në mesin e popujve tanë.

Me rastin e kësaj vizite në Shkodër, Ambasadori i Kuvajtit do të marrë pjesë edhe në inaugurimin e përfundimit të rehabilitimit të plotë të objektit të "Shtëpisë së Fëmijëve", Shkodër dhe pajisjes së tij me orendi të reja, projekt i realizuar në koordinim me Myftininë Shkodër.



Ditën e xhuma, më 16 maj 2014, është zhvilluar ceremonia për inaugurimin e përfundimit të punimeve për rehabilitimin e “Shtëpisë së Fëmijës”, Shkodër, si pjesë e një projekti të mbështetur nga Ambasada e Kuvajtit në Tiranë.

I pranishëm në këtë ceremoni festive, ishte vetë Ambasadori i Shtetit të Kuvajtit në vendin tonë, z. Najeeb Al-Bader, shoqëruar edhe nga Ambasadori i Libisë, z. Isam Ferexh Ibn Xhelil dhe Myftiu i Zonës Shkodër, Imam Muhamed Sytari.

Në emër të institucionit të “Shtëpisë së Fëmijës”, Shkodër, ka përshëndetur drejtori, z. Arjan Dushaj, i cili ka falënderuar përzemërsisht mbështetjen e Ambasadës së Shtetit Kuvajtit për ndryshimin e pamjes së

AMBASADA E KUVAJTIT REHABILITON “SHTËPINË E FËMIJËS”, SHKODËR



theksuar se kjo ndihmë e dhënë nga Shteti i Kuvajtit, është një shprehje e miqësisë dhe vëllazërisë në mesin e dy popujve tanë. Ai ka konfirmuar se me mbarësinë e Zotit, Ambasada e Kuvajtit do të vazhdojë të jetë e pranishme në Shkodër, nëpërmjet projekteve të dobishme në të mirë të komunitetit dhe njerëzve në nevojë.

Fëmijët, të gëzuar nga dhurata e Ambasadës së Shtetit të Kuvajtit, i kanë dhuruar z. Al-Bader, lutjet dhe mesazhet e tyre të përzemërta, në një vazo të zbukuruar nga duart e tyre.

objektit, ku banojnë 44 fëmijë jetimë të moshave nga 6-20 vjeç. Në fjalën e tij, z. Dushaj ka falënderuar edhe Myftininë Shkodër për interesimin e vazhdueshëm dhe koordinimin për zbatimin me sukses të këtij projekti me vlera. Ai ka theksuar se përveç ndërhyrjes në krejt objekt, është bërë edhe zëvendësimi i krejt orendive dhe mobilierisë së brendshme, orendive të kuzhinës, veshmbathjes së fëmijës etj.

Nga ana e tij, Ambasadori i Kuvajtit, z. Najeeb Al-Bader, ka shprehur kënaqësinë e tij për pjesëmarrjen në këtë ceremoni domethënëse, duke



U PËRKUJTUA ISRAJA DHE MIRAXHI I HZ. MUHAMMEDIT (A.S)

Pasditën e së dielës, më 25 maj 2014, Myftinia Shkodër, organizoi në xhaminë e Parucës një tribunë fetare, të gërshtuar me ilahi dhe salavate, në përkujtim të Natës së Bekuar të Israsë dhe Miraxhit, një ndër mrekullitë më të spikatura në jetën e Hz. Muhammedit (a.s).

Aktiviteti ka nisur me fjalën hapëse, nga teologu Ervil Kuçi, që ka bërë një shpjegim teologjik rreth mrekullisë së Israsë dhe Miraxhit, bazuar në ajetet kur'anore që flasin për këtë natë të bekuar.

Më pas, në fjalën e tij përshëndetëse, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari ka theksuar se, Nata e Israsë dhe e Miraxhit është nata e familjes, pasi në vende të ndryshme në Kur'an është vënë theksi te edukimi i familjes me faljen e namazit, që ishte dhuntia më e madhe e kësaj nate. Myftiu ka bërë thirrje që fryma e imoralitetit dhe devijimet nga morali i fesë dhe traditave tona fetare dhe kombëtare, që po mbështeten edhe nga politika dhe media, janë një rrezik që nuk duhet toleruar, duke mos heshtur, për asnjë arsye.

Aktiviteti ka vijuar me ligjëratën e



mbajtur nga H. Edmir Smajlaj, Myftiu i Malësisë së Madhe, që ka hedhur dritë mbi vlerën e namazit në jetën e muslimanit. Myftiu ka bërë thirrje që muslimanët të jenë më të vëmendshëm dhe më të lidhur me këtë dhuntia hyjnore, që iu obligua Hz. Muhammedit (a.s) në natën e Israsë dhe Miraxhit. Myftiu ka theksuar se namazi është lidhja më e rëndësishme që mban muslimanin të lidhur pas fesë së tij.

Më pas, medresisti Orhan Dani dhe H. Sami Muçej, kanë kënduar pjesë nga mevludi, salavate dhe ilahi, në përkujtim të kësaj nate.

Teologu Lavdrim Hamja, në referatin e tij, ka folur mbi Isranë dhe Miraxhin, parë nga një këndvështrim shkencor dhe teologjik, ku ka sjellë argumente nga Kur'ani, Tradita profetike dhe shkenca, në vërtetim dhe shpjegim të kësaj ndodhie, që akoma sot mbetet një mrekulli që sfidon materializmin dhe botën afetare.

Në fund, të pranishmit janë uruar në mes vete, duke u lutur që Muaji i Madhërueshëm i Ramazanit t'i gjejë në më të mirën gjëndje muslimanët e Shkodrës dhe të mbarë botës islame.



NATA E NAMAZIT...

Kjo është Nata e Namazit... Mrekullia që i jep vlera njeriut, si krijesa më e përsosur, që Zoti krijoi, si për t'i thënë: "Drejt Meje, s'ka nevojë të trokasësh në asnjë derë tjetër... Eja, mos ngurro, Dera Ime është përherë e hapur për ty..."

Kjo është Nata e Namazit, ku fisnikëria e njeriut mbetet prekje Miraxhi dhe ku namazi, flak tutje zemrës së mborjtur nga Teuhidi, të gjitha simbolet e shirkut dhe personazhet e tij në jetën tonë...

Kjo është Nata e Namazit, ku pastërtia e gjymtyrëve, që pikojnë ujë abdesti, rrezaton Dritën e Pastërtisë, me të cilën besimtarët do të hyjnë në xhennetet e premtuara, nën flamurin e Dashnisë së Pastër...

Kjo është Nata e Namazit, në të cilën mblidhen kujtimet e krejt pejgamberëve të dashur, që me përulje e respekt, teksa shqiptuan emrin "Muhammed", u bënë Dritë Miraxhi, në një Natë të Bekuar, sa një jetë me bekime netësh me prekje miraxhesh...

Kjo është Nata e Namazit, që me Dritë afrimi zbukuron fytyrat e kërkuesve të Dashnisë Tande, teksa në ruku thërrasin: *Ja Vedúd*, o Zot i gjithësisë...

Kjo është Nata e Namazit, që tokën gjallëron me lotët e të penduarve, kur në sexhdet e kthimit, emrin Tënd thërrasin: *Ja Gafurr*, o Pranues i Faljes dhe o Falës i gabimeve dhe gjynaheve pafund...

Kjo është Nata e Namazit, sekretet e së cilës, mbushin ditë pas dite jetën tonë, me Bukurinë e adhurimit të Atij që është Një, *All-llahu Ehad*...

Kjo është Nata e Namazit, ku gjithësia, me gjuhën e përuljes në dashni, thërret në prehje: "*Ijjake na'budu ve ijjake nesteín...*", teksa rrugëton qetësisht në hapat e Resulull-llahut drejt Sidretul-Muntehasë...


Kjo është Nata e Namazit...

Shkroi: **Muhamed B. Sytari**

(25 maj 2014, në qetësinë e Natës,
që me sytë nga qielli, përjeton prekjet e Mrekullisë)

“I PA TË METË ËSHTË AI (ALL-LLAHU), QË ROBIN E VET
E KALOI NË NJË PJESË TË NATËS
PREJ MESXHIDI HARAMIT DERI NË MESXHIDI AKSA,
RRETHINËN E TË CILËS NE E KEMI BEKUAR,
PËR T’IA TREGUAR ATIJ (MUHAMMEDIT A.S.) DISA NGA ARGUMENTET TONA.
VËRTETË, AI (ALL-LLAHU) ËSHTË DËGJUESI, SHIKUESI” .

(SUREJA “ISRA”, 1)



Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Dizajn & Grafik:
Bledar Xama

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

E-mail:
udhaislame@myftinia-shkoder.org
Website:
www.myftinia-shkoder.org